

LIGJ
Nr.9837, datë 3.12.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8093, DATË 21.3.1996
“PËR REZERVAT UJORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 61 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në paragrafin e dytë bëhen këto ndryshime:

a) fjalia e parë riformulohet si më poshtë:

“Për shkeljet e parashikuara në nenet 14 pika 1 shkronja “ë”, 24 paragrafi i parë dhe i dytë, 47, 48, 49 dhe 50 të këtij ligji, kundërvajtësi dënohet nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në varësi të shkallës së shkeljes, me:”;

b) shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) gjobë 500 000 lekë;”;

c) shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) pezullim të veprimtarisë deri në 10 ditë, në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit, për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e rezervave ujore;”.

2. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar paraqet kërkesën për heqjen e licencës profesionale, personale e të shoqërisë pranë organit përkatës, në rast të ndërtimit pa leje, të shfrytëzimit të kundërligjshëm të inerteve, si dhe të lejes së veprimtarisë përkatëse të shoqërive, që shkelin dispozitat e mësipërme, kur vërejnë shkelje të kushteve teknike të zbatimit apo projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit.”.

3. Paragrafi i katërt shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 69 bëhen këto ndryshime:

a) në paragrafin e parë dhe të tretë fjalët “Drejtorit të Policisë së Ndërtimit zëvendësohen me fjalët “Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar”;

b) në paragrafin e dytë, të pestë dhe të shtatë, fjalët “organit/eve/et të Policisë së Ndërtimit” zëvendësohen me fjalët “Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar”;

c) paragrafi i gjashtë ndryshohet si më poshtë:

“Gjoha, si dhe shpenzimet, që përballohen nga autoriteti i ujit dhe nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, paguhen nga kundërvajtësit brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të tyre ose nga data kur ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës.”;

ç) në paragrafin e tetë fjalët “Policia e Ndërtimit” zëvendësohen me fjalët “Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5544, datë 13.12.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi